

## Thirrje për Shprehje të Interesit nga Organizatat e Shoqërisë Civile për t' u bërë pjesë e Grupeve Punuese Kombëtare për Reformën në Administratë Publike

Grupi për Studime Juridike dhe Politike – GSJP, në emër të rrjetit rajonal Think for Europe Network (TEN) dhe në kuadër të [projektit WeBER](#), fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në Kosovë të cilat janë të interesuara të përfshihen në krijimin dhe funksionalizimin e mëtutjeshëm të Grupeve Punuese Kombëtare (GPK) për monitorimin e Reformës në Administratë Publike (RAP) në shtetet e Ballkanit Perendimor.

Grupi Punues Kombëtar (GPK) do shërbejë si një mekanizëm këshillues kombëtar që u mundëson pjesëmarrjen organizatave të shoqërisë civile në dialogun me autoritetet relevante publike në hartimin dhe monitorimin e procesit të Reformës në Administratë Publike në Ballkanin Perendimor. GPK-të do të formohen në secilin nga shtetet e Ballkanit Perendimor si pjesë e një mekanizmi më të gjërë konsultativ për dialogun mbi Reformën në Administratë Publike – [Platformën WeBER](#), e themeluar në Podgoricë, në Nëntor të vitit 2016.

GPK-të sigurojnë që dialogu mbi Reformën në Administratë Publike të jetë gjithëpërfshirës sa i përket shoqërisë civile, përmes pjesëmarrjes së organizatave lokale që operojnë në të dy nivelet, qendror dhe lokal.

Antarësimi në GPK është i hapur për të gjitha OShC-të e interesuara. Nëse organizata juaj është e interesuar të bëhet anëtarë i GPK-së, ju lutem dërgoni Shprehjen e Interesit që përfshinë dhe një përshkrim të shkurtër të përvojës së mëparshme të organizatës në procesin e Reformës në Administratë Publike (përvojë bazike). Nëse organizata juaj nuk ka qenë më parë aktive në këtë fushë, mjafton të theksoni motivin tuaj për tu angazhuar në procesin e RAP.

Në mënyrë që Aplikacioni juaj të jetë i plotë, përveq Shprehjes së Interesit, ju lusim të plotësoni [pyetësorin për vlerësimin e nevojave të OShC-ve për ngritjen e kapaciteteve në fushën e PAR](#). Pyetësorin mund ta shkarkoni këtu:

[https://www.surveymonkey.com/r/WeBER\\_NWG\\_Questionnaire\\_Kosovo](https://www.surveymonkey.com/r/WeBER_NWG_Questionnaire_Kosovo). Afati i fundit për dorëzimin e Aplikacionit është **13 Mars 2017**, përmes postës elektronike tek: [njomza.arifi@legalpoliticalstudies.org](mailto:njomza.arifi@legalpoliticalstudies.org).

Pse t'i bashkangjiteni GPK-së?

Natyra e veçantë e platformës WeBER dhe GPK-ve, mbështetet në qasjen gjithëpërfshirëse e cila përqendrohet në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe ndërtimit të partneritetit shumë shtresor në mes

të organizatave të shoqërisë civile, me qëllim të rritjes së ndikimit në monitorimin e proceseve në RAP.

Në veçanti, GPK-të:

- Përfshijnë organizatat lokale që shprehin interesim të theksuar apo janë duke monitoruar punën e institucioneve në nivel lokal ose rajonal
- Krijojnë mundësi për zhvillimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile përmes trajnimeve, punëtorive dhe mbështetjes në implementimin e metodologjisë për monitorimin e RAP, në nivel qendror dhe lokal
- Krijojnë mundësi për organizatat lokale me pak përvojë në fushën e RAP që të nisin ndërtimin e portfolios rreth RAP, duke i inkurajuar kështu që të propozojnë projekte [dhe aplikojnë për grante të vogla për monitorimin e reformës së administratës publike](#).

Motivi mbrapa krijimit të GPK-ve është përfshirja e sa më shumë organizatave që është e mundur, në mënyrë që të krijohet një mekanizëm i gjërë kombëtar por kredibil, i cili do përfaqësoj pikpamjet dhe qendrimet e shoqërisë civile kundrejt dialogut me institucionet publike lidhur me procesin e monitorimit të RAP. GPK-të rrjedhin nga logjika dhe struktura e Platformës WeBER (e paraqitur në grafikonin e mëposhtëm), e cila ofron një forum të përbashkët për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e RAP dhe dialogun që zhvillohet në nivel rajonal dhe në nivel të vendit. Secili konzorcium në kuadër të platformës paraqet një GPK për shtetin përkatës, duke pasur gjithnjë parasysh specifikat e mjedisit në të cilin operojnë organizatat e shoqërisë civile, si dhe disponueshmëria dhe nevoja për hulumtime të bazuara në fakte si dhe avokim për RAP. Organizatat që do udhëheqin dhe koordinojnë punën e GPK-së (të ashtuquajtur "konzorciumi kombëtar"), të cilat janë njëkohësisht pjesë e Platformës rajonale të WeBER, janë:

- Grupi për Studime Juridike dhe Politike - GJSP, Prishtinë (Koordinator i GPK-së dhe koordinator i projektit WeBER për Kosovë);
- Instituti GAP, Prishtinë;
- Instituti për Zhvillimin e Politikave – INDEP, Prishtinë;
- Iniciativa për Progres – INPO, Ferizaj

Anëtarët e Platformës në Kosovë , si dhe anëtarët e shteteve të tjera<sup>1</sup> janë përzgjedhur përmes një Thirrjeje të Hapur për Shprehjen e Interesit.

Për më shumë informata rreth funksionimit, strukturës dhe benefiteve nga antarësimi në Grupet Punuese Kombëtare për Reformën në Administratë Publike, ju lutem konsultoni Draftin e Konceptit

---

<sup>1</sup> Për të parë të gjithë anëtarët e projektit WeBER, ju lutem vizitoni: <http://www.par-monitor.org/pages/members>.

të Grupeve Punuese Kombëtare për Reformën në Administratë Publike<sup>2</sup>, i bashkëngjitur si Shtojcë në këtë Thirrje për Shprehje të Interesit.

Qëllimi i përgjithshëm i WeBER është të përmirësoj rendësinë, pjesëmarrjen dhe kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe medieve në Ballkanin Përendimor (BP) për të avokuar dhe ndikuar në krijimin dhe implementimin e Reformës së Administratës Publike (RAP). Për më shumë informata rreth projektit WeBER, ju lutem vizitoni faqen zyrtare të projektit: <http://www.par-monitor.org>.

---

<sup>2</sup> Koncepti për krijimin e Grupeve Punuese Kombëtare për RAP është hartuar në kuadër të projektit tre vjeçar WeBER (Western Balkans Enabling Project for Civil Society Monitoring of Public Administration Reform - WeBER), financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkë-financuar nga Mbretëria Holandeze. Për më shumë informacion, vizitoni: <http://www.par-monitor.org>